

Joachim Röhm

## ZANATI I VESHTIRË I PËRKTHIMIT LETRAR

Referat i mbajtur në konferencën e organizuar nga Departamenti i Gjuhës Gjermane i Universitetit të Tiranës, me rast të tetëdhjetë vjetorit të lindjes së përkthyesit të shquar shqiptar Robert Shvarc, në vitin 2012

Të nderuar zonja dhe zotërinj, të dashur miq!

Ju lutem, mos e merrni për ndonjë frazë kortezie kur them se për mua është jo vetëm një gëzim por edhe një nder që më është dhënë mundësi t'ju drejtohem në kuadër të kësaj konference shkencore, të dedikuar kujtimit të përkthyesit të madh Robert Shvarc.

Jam lutur t'ju flas në shqip dhe e pranova. Pas gjithë këtyre viteve që jam në kontakt të ngushtë me shqipën, kam një farë shprese se do të arrij t'i shpreh mendimet e mia edhe në këtë gjuhë të bukur, megjithëse nga përkthyesi letrar kërkohet më shumë përsosmëria e formulimeve të përkthimit dhe më pak elokuenca në gjuhën tjetër nga përkthen. Pres mirëkuptimin tuaj për mungesën e shkëlqimit retorik, i cili me siguri do të shpaloset në kumtesat e bashkëreferentëve të mi.

I përmenda kontaktet e mia shumëvjeçare me gjuhën shqipe, faktikisht mund të them se gjysmën e jetës sime ndërkohë jo aq të shkurtër kam kaluar në marrëdhënie të ngushta me shqiptarët, me gjuhën, kulturën dhe sidomos letërsinë e tyre, në profesionin tim si përkthyes letrar, por jo vetëm. (Ndërkohë, p.sh. jam edhe gjyshi i një mbese të vogël gjysëmshqiptare.) Të them të vërtetën, terma si dashuri ose pasion nuk përshkruajnë mirë karakterin e këtyre marrëdhënieve me botën shqiptare, më saktë do të ishte ndoshta fjala gjermane "verwachsen", ç'do të thotë "të bëhesh të një mishi me dikë". Mishi nganjëherë të dhemb, prandaj kërkoj që tani falje për ndonjë konstatim kritik. Zgjedhja e temës së referatit tim është lënë në duart e mia, dhe s'kisha të veshtirë ta gjeja: Ne qoftë se kam një fituar një farë kompetence, atëherë në fushën e përkthimit. Të gjithë përkthyesit kanë qejf të flasin për punën e tyre të mundimshe dhe fiznike, edhe unë. Përkthimi pra. Mund të them që në fillim të rrugës sime tashme të gjatë si përkthyes letrar ka qenë njohja me Robert Shvarcin.

Ne – d.m.th. unë, shoqja ime Doris dhe të dy djemtë tonë atëherë mjaft të vegjel, tre dhe katër vjeçar – erdhëm këtu në Tiranë në vitin 1977, për të punuar te Radio Tirana dhe te Shtëpia Botuese "8 Nëntori". Motivet që na shtynë atëherë të shkonim për të punuar në një vend komunist s'mund të shpjegohen me pak fjalë: lidheshin me hijën e zezë të nacizmit që në në dy dekadat të para pas Luftës së Iltë Boterore, në të cilat ishim rritur ne, vazhdonte të rëndonte mbi Gjermaninë. E konsideroj si një farë ironie të hidhur

që shumë të rinj nga brezi ynë, nën shokun e holokaustit mendonin që për të mënjanuar rrezikun e kthimit të nacizmit, duhej të kërkohej ndihmë tek ideologjia e tjetër e madhe totalitare e shekullit XX, te komunizmi. Unë për veten time refuzoj rreptësisht të shfaqësohem me llafët e radhës, që ishim të rinj, idealist, që s'deshëm të keqen, që s'ishim të vetëdijshëm për pasojat etj. Secili prej nesh mban përgjegjësinë për vendimet dhe veprimet e tija, ne nuk mund të besojmë që mjafton t'i lëmë në heshtje, por duhet t'i pranojmë gabimet tona, për të nxjerrëkonkluzionet e nevojshme. Ideologjitë totalitare, sistemet totalitare (thash para disa viteve në një intervistë me gazetën gjermane "Frankfurter Allgemeine Zeitung") kanë dhunën dhe krimin në gjak, sepse pretendojnë të kenë të drejtën t'u imponojnë të tjerëve atë që e quajnë të vërtetën e tyre ekskluzive edhe në menyrë të dhunshme. Krimi më i madh i totalitarizmave të të gjitha ngjyrave është shtypja ose përkufizimi i mendimit dhe vullnetit të lirë të individit. Kjo është edhe vdekja e letërsisë. Fatmirësisht, jo vetëm, por edhe përvojat shqiptare më kanë ndihmuar të çlirohesh herët, që para rënies së botës komuniste, nga botëkuptimi komunist.

Megjithatë dua të them që nuk pendoj aspak qëndrimin këtu në Tiranë, në fund të viteve 70. Këtu jam njohur me Shqipërinë dhe shqiptarët, kam mesuar gjuhën shqipe dhe – ndonëse tekstet, me të cilat merreshim, në përghithësi nuk meritonin aspak të përktheheshin në gjuhë të tjera – më është dhënë mundësia të përvetësoja zanatin e përkthimit. Gjatë asaj kohe, Robert Shvarci, me të cilin bashkëpunonim ngushtë edhe në Radio, edhe në shtëpinë botuese, na fali (gjë që është më e rëndësishmja) miqësinë e tij dhe na ndihmonte të kuptonim diçka nga sekretet e Shqipërisë, na ngrohte zemrën me dashurinë e tij të flaktë për letërsinë, mua më dha një shëmbull me pasionin e tij për artin e përkthimit. I paharrushëm për mua është edhe humori i tij i mprehtë (edhe ne qoftë se shpesh herë ishte pa humor). Nonkoformizmi i tij, një fenomen i rrallë në atë kohë, ishte inkurajues.

Që i kam mbetur besnik letërsisë shqiptare dhe përkthimit, në një masë të konsiderueshme është merita e tij. Robertin nuk do ta harroj derisa jam i gjallë.

Ndërkohë, pasi kam përkthyer rreth tridhjetë libra dhe një numër të madh novelesh, tregimesh, poezish, dramash, esesh, këngësh popullore etj. që u botuan në antologji ose revista letrare, zakonisht me aplausin e kritikës dhe publikut letrar, po nganjëherë edhe pa, pas nderimeve të ndryshme, mund të them që i përkas kategorisë së përkthyesve me përvojë, të stërvitur në punë dhe të rrahur me vaj dhe me uthull, por megjithatë shpesh herë me torturon dyshimi se ajo, me të cilën merrem, është një flirt me të pamunduren, tentativa e kot për të bërë çudira, për të gjetur gurin filozofofik, për të prodhuar ar. Punë sisifi. Prandaj nuk isha aspak i befasuar kur lexova se në perandorinë e vjetër egjiptiane njerëzit besonin që përkthyesi ka forca jashtëtokësore, mbinatyrore dhe bile është në gjendje të komunikojë me perënditë.

Sa e bukur. Fatkeqësisht, në kohët e sotme imazhi i përkthyesit është shumë më modest, gjë që pasqyrohet edhe në shpërblimin e mjerë të mundimeve të tij rraskapitëse.

Një padrejtësi e madhe, kur marrim parasysh se evropianizimi i Evropës dhe globalizimi i botës nuk mund të imagjinohen pa punën e zellshme e një armate të stërmadhe të përkthyesve kudo në rruzullin tokësor. Me anë të përkthimit, perandoria romake përvetësonte arritjet filozofike dhe shkencore të grekëve të vjetër, duke u bërë superfuqi. Mbretërit spanjoll shfrytëzonin thesarin e njohurisë së dijetarëve arabik, pas rënies së shtetit të maurëve, duke dalë në atë menyrë në krye të botës. Procese kulturo-historike si Rilindja e madhe evropiane në shekullin 15të dhe 16të si dhe të gjitha rilindjet kombëtare, duke përfshirë këtu edhe Rilindjen kombëtare shqiptare, ishin edhe procese të përvetësimit të arritjeve kulturore dhe të ideve të tjerëve, me anë të përkthimit. Dhe, siç tha një kolegu im nga Gjermani, çdo përkthim i arritur letrar është rilindja e një shkrimtari. Me sa duket, pra, çdo përkthyes është një mjek obstetrik.

Nuk është për t'u çuditur që në kohën e Romantikës, epokës kulturo-historike, gjatë të cilës lëvizjet kombëtare në Evropë zhvilloheshin hovshëm, edhe përpjekjet për të formuluar një teori të përkthimit shtoheshin.

Mos kini frikë, nuk kam ndër mend të ndërmarr me ju një marshim në shkretetirat jomikëpritëse të teorisë, se pari nuk dua t'ju mërzis, por arsya kryesore është se unë i përkas grupit shumë të madh të përkthyesve letrar që vuajnë nga një mosbesim të theksuar ndaj teorisë së përkthimit ose bile e shohin me armiqësi. Në gjysëm shekullin e fundit, shkenca e translacionit (Translationswissenschaft) ka bërë ca hapa mjaft të medha përpara. Frytat e këtyre hulumtimeve vërtet na ndihmojnë të kuptojmë një çik më mirë çfarë po ndodh në këtë panair të llarmishëm, por për fat të keq nuk vlejnë si rregulla ose mjete ndihmëse në luftën e rrezikshme të përkthyesit të vetmuar letrar me fjalët, fjalitë, kuptimet dhe nënkuptimet, dykuptimshmëritë, ngarkesat socio-kulturore, trillet e autorit, për të mos harruar kohën, në presionin e së cilës duhet të marrim vendime të nepasnjëshme që nganjëherë shkaktojnë keqkuptime dhe gabime nga më bizaret, dhe kurrë nuk mund të mbështetemi në një manual shpëtues, një rregullore të përgjithshme dhe të plotfuqishme, Kodin e Madh të Përkthimit.

Sigurisht, me gjithë rezervat ndaj teorisë, çdo përkthyes në këtë botë reflekton vazhdimisht punën e vet, dhe në shumicën e rasteve bile di të shpjegojë dhe të justifikojë menyrën e tij vetjake të përkthimit, rezultatin e tentativave të tij.

Po të pyesje një nxënës të shkolles fillore ... jo, po të ndalje kalimtarin e parë në rrugë që s'ka çarë kokën kurrë për makinacionet e ndërmjetësve gjuhësore, duke mos ditur në çfarë mase varet edhe jeta e tij nga puna e tyre ... kur të pyesje një person të zakonshtëm: Ç'bën vallë një përkthyes? – përgjigja do të ishte pak a shumë: Ky i kupton fjalët e një gjuhe të huaj dhe sjell kuptimin në gjuhën tonë! Një herë, në një sallë gjyqi, pasi unë, si përkthyes me gojë, s'kisha kapur dot domethënien e deponimit të një të akuzuari ose dëshmitari, një gjyqtar më kërkoi t'ia përktheja "fjalë për fjalë" ç'kishte thënë folësi. E bëra, por doli që vetë fjalët nuk ishin më kuptuese, përkundrazi, një ngatërresë e vetme. Pra, përkthim "fjalë për fjalë" nuk ka. Po të kishte, atëherë veglat kompjuterike si "Google Translator" prej kohësh do të kishin dënuar të gjithë përkthyesit prej mishi e

gjaku me papunësi të përjetshme. Në të vërtetë, këto vegla, në rastin më të mirë, na furnizojnë me një ide të përafërt, po jo shumë të përafërt, të asaj që deshi të thoshte autori. Përkthyesi i gjallë është akoma i pashmangshëm. Sepse përkthimi nuk është një punë fjalësh, por një punë teksti. Kompleksiteti i një teksti shprehet jo kryesisht në fjalët e një teksti, por në barrën në shikimin e parë të padukshme që transporton ky.

Në shumë raste mund të quhet e mjaftueshme ose bile e kenaqshme kur përkthimi jep me saktësi e duhur kuptimin e asaj çfarë është thënë ose shkruar në gjuhën tjetër. Për shëmbull, kur gjuha shërben vetëm për të transportuar fakte. Për shëmbull në fushën e ekonomisë ose të juridikës, në jetën administrative dhe biznesi. Në punën e përkthyesit me gojë, të cilin gjermanisht e quajmë "Dolmetscher", me një fjalë të lindur në kohën e gjermanishtes së mesme. Të shkretit "Dolmetscher" i bie detyra përmbajtjen e fjalëve ose shpesh herë të llogaritjes së personave të paafte për formulimin e qartë të mendimeve, ta transmetojë pa humbje kohe në një gjuhë të huaj, d.m.th. pa pasur kohë të mendohet, të konsultojë një fjalor ose një koleg, të marrë frymë. Për çudi, në varësi nga aftësia dhe përvoja e përkthyesit, kjo gjë në shumicën e rasteve funksionon, të themi funksionon pak a shumë. Duhet të pohohet se nganjëherë mosinqizimi në një regjistruar zëri e shpeton përkthyesin nga turpi dhe nga të qeshurat e botës. Nuk dua të diç sa tragedi njerëzore janë shkaktuar vetëm dhe vetëm nga përpjekjet e dështuara të përkthyesve me gojë. Kush deshiron të mësojë më shumë për dredhitë e këtyre njerëzve, duhet të lexojë romanin *Corazón tan blanco* (*Zëmra ime e bardhë*) të autorit spanjoll Javier Marias.

Ndryshe nga përkthyesi me gojë, të cilin mbron karakteri fluturak i punës së tij, përkthyesi me shkrim në fushën e politikës, ekonomisë, drejtësisë, administratës, teknikës etj. duhet t'u nënshtruar kontrolleve e vazhdueshme, të shumanshme, shpeshherë keqdashëse të punës së tij të përjetësuar në letër ose media të tjera. Syve vigjilente nuk do t'u shpetojë as gabimi më i vogël. Por edhe këtyre përfaqësuesve të esnafit të përkthyesve nuk mund të kërkohet më shumë se sa të riprodhojnë me besnikëri maksimale përmbajtjen e shkrimeve origjinale. Kjo është një punë vigane që kërkon dije gjuhësore, përvojë, ndërgjegje dhe përpikmëri me bollëk. Kush, nga radhe e degjuesve gjermanishtfolëse, nuk e beson, atij i propozoj të hapë Kodin Penal i Republikës Federale të Gjermanisë dhe të përpiqet të përkthejë tekstin e nenit 271 (Mittelbare Falschbeurkundung)<sup>1</sup>. Por edhe fraza e shumëpërdorur juridike "billigend in Kauf nehmen" mund të hedh në dëshperim guximtarin që përpiqet ta përkthejë në shqip.

Mirëpo, të gjitha këto veshtirësi janë pak në krahasim me punën e sisifit, siç e quajta, të përkthyesit letrar. Midis mendimtarëve të parë në Gjermani që merreshin hollësisht me

---

<sup>1</sup> „§ 271 Mittelbare Falschbeurkundung.

(1) Wer bewirkt, dass Erklärungen, Verhandlungen oder Tatsachen, welche für Rechte oder Rechtsverhältnisse von Erheblichkeit sind, in öffentlichen Urkunden, Büchern, Dateien oder Registern als abgegeben oder geschehen beurkundet oder gespeichert werden, während sie überhaupt nicht oder in anderer Weise oder von einer Person in einer ihr nicht zustehenden Eigenschaft oder von einer anderen Person abgegeben oder geschehen sind, wird mit Freiheitsstrafe bis zu einem Jahr oder mit Geldstrafe bestraft.

problemet e përkthimit, ka qenë teologu dhe filozofi Friedrich Schleiermacher (që lindi në vitin 1768 dhe vdiq në vitin 1834), Siç na informon WIKIPEDIA, ai mund të konsiderohet si themeltari i hermeneutikës moderne. Mendimet e tija nuk kanë humbur freskinë dhe vlerën e tyre. Përkthyesit e veprave letrare dhe shkencore, duke i ndare nga përkthyesit me gojë dhe me shkrim në fushën e biznesit (për të përdorur një term tmer-rësisht modern), i quaiti "përkthyesit e mirëfilltë", megjithëse ishte i bindur se të gjitha përpjekjet e tyre janë kushtuar dështimit. Tekstet artistike, "ku forma gjuhësore me përmbajtjen e transportuar shkrihen duke formuar unitete të një rendi më të lartë" (Jekatherina Lebedewa), për të ishin thjesht të papërkthyeshem.

Mund të mbaroja shtjellimet e mia këtu, po të ishte kjo fjala e tij e fundit. Por për çudi, Schleiermacheri në të vërtetë dinte t'i çmonte fare mirë përpjekjet e përkthyesve në luftën e ashpër me të pamundurën, ndryshe nuk do të ishte marrë aq zellshëm me problemet praktike të përkthimit. Mirëpo, nga një konkluzion nuk hoqi dorë kurrë: Përkthimi i përsosur është dhe do të mbetet utopi! Të gjithë ne që merremi me përkthimin pajtohemi me të. Por që dijmë që riprodhimi i plotë dhe pa humbje të një veprë letrare në një gjuhë tjetër është e pamundur, nuk mund të na pengojë të vazhdojmë punën tonë në dobi të njerëzimit.

Por çfarë kushtesh duhet të plotësohen për të arritur në rezultate, të themi: të kënaqshme?

Schleiermacheri, i furnizuar me bekimin e Goethes, na ofron dy mundësi kryesore, të themi: të pranueshme.

Ose, thonë të dy mendimtarë të mëdhenj me një gojë, përkthyesi (si instanca ndërmjetëse, me fjalët e mia) duhet ta sjell lexuesin tek autori, ose autorin te lexuesi.

Çfarë do të thotë kjo, me fjalë të thjeshta?

Në rastin e parë, përkthyesi jo vetëm përpriqet të mos fshehë që vepra e autoritë gjuhës tjetër mund të mbetet veç i huaj për shoqërinë, gjuhën, kulturën, doket etj. të vendit mikpritës, sipas Schleiermacher-it bile ka për detyrë ta nënvizojë karakterin e huaj të veprës me anë të "tëhuajzimit" (Verfremdung). Vetëm në këtë mënyrë, mendonte dijetari, vepra mund të pasurojë kulturën pritëse. Pra, autorit i pranohet e drejta e mysafirit, jo më shumë dhe jo më pak.

Në rastin e dytë, përkthyesi, për ta sjell autorin te lexuesi, përpriqet ta bëjë sa më të kuptueshëm, sa më të kapshëm, sa më dashur për lexuesin, gjithashtu me qëllim ta pasurojë kulturën pritëse. Pra, autorit i jepet e drejta e qytetarit, autori natyralizohet.

Një çerek mijëvjeçar para Schleiermacher-it, reformatori gjerman Martin Luther, një nga përkthyesit më të rëndësishëm në botë, për të shpjeguar metodën e tij të përkthimit të Librit të Shenjtë, pa çarë kokën shumë, krijoi termin "Verteutschung" - gjermanizim. Deshi "t'i shikonte popullit në gojë". Rëndësi për të kishte vetëm të bënte përmbajtjen e

biblës sa më të kuptueshme për popullin e thjesht. "Verteutschung" pra. Edhe shqiptarët kanë qejf të përdorin termin "shqipërim".

Kampi i përkthyesve ndahet edhe sot në partizanë të njërës ose tjetrës metodë, por sipas të gjitha gjasave, çdo përkthim letrar përban elemente karakteristike e të dy meny-rave të përkthimit.

Por një gjë vlen gjithmonë: Një vepër e artit letrar duhet të ruaj karakterinë e vet edhe si përkthim. Prandaj, për shëmbull, dyshimi i përhapur ndaj përkthimeve prozaike të poezi-së janë me vend. Goethe-ja thotë prerazi se "në poezi vlej në vetëm veprat më të përkry-era". Aq më shumë vlen kjo fjalë për përkthimet e poezive.

Unë, si shumë kolegë, preferoj "menyrën natyralizuese" të përkthimit. Gëzohem kur lexuesit më vërtetojnë se libri i përkthyer "lexohet sikur të ishte shkruar në gjuhën gjermane", megjithëse kam të qartë (për të parafrazuar një shprehje të Schleiermacher-it) që fëmija që lindur në territorin gjermanishtfolës është bërë me të njejtën nënë, por nga një baba tjetër.

Një vepër letrare e përkthyer në menyrë të përkryer, duke ruajtur afërsinë maksimale në përmbajtje dhe formë, d.m.th. meriton të konsiderohet si ekuivalent i origjinalit, mund të quhet "rikrijim besnik" (treue Neuschöpfung). Ky term është vetëm në shikimin e parë kontradiktor.

Por ç'duhet të bëj përkthyesi për të arritur në "rikrijimin besnik" të origjinalit?

Nga miku im, ish-matematicieni, shkrimtari dhe përkthyesi Fatos Kongoli, di që në teori-në e shkencës dhe logjikës flitet për kushte të nevojshme dhe kushte të mjaftueshme. Ju lutem t'i lejoni një personi të paditur dhe të pastërvitur në mendimin teoretik, siç jam unë, t'ju shpjegoj si mund të përdoret ky parim në përkthim: Një kusht që duhet të plotësohet patjetër për të arritur një qëllim, quhet kusht i nevojshëm. Mund të jetë që vetëm plotësimi i këtij kushti nuk mjafton për të arritur qëllimin, që duhet të plotësohen edhe kushte të tjera të nevojshme. Me në fund, se bashku formojnë kushtin e mjaftueshëm. (Shpresoj se nuk kam bërë gafë, ne qoftë se po, ju kërkoj falje.)

Por nejtë. ushti i parë i nevojshëm, të cilin duhet të plotësoj përkthyesi për të pasur sukses është (kush s'e ka ditur) që të kuptojë dhe të njohë mjaft mirë gjuhën e origjinalit, gjuhën, nga përkthen. Zakonisht e quajmë "gjuhë burimi", *Quellsprache*. Nuk mund të transmetojmë diçka në një gjuhë tjetër, pa e kuptuar. Procesi i përkthimit, pra, është një proces hermeneutik. Shpeshherë përkthyesi duhet të interpretojë, me gjithë rrezikun të gabojë. Edhe kur supozojmë se përkthyesi e zotëron "gjuhën burimi" në menyrë më të përsosur, ky është një proces shumë i ndërlikuar. Vendimet nganjëherë dalin të gabuar, qoftë për shkak të mendjelehtësisë, qoftë për arsye tjetër. S'u shmangemi dot gabimeve, sidomos kur duhet punuar nën presionin e kohës. D.m.th. gjithmonë. Nganjëherë gabimet tona bien në sy mënjehërë, edhe lexuesit që nuk di "gjuhën burimi", nganjëherë, për arsye të ndryshme, nuk vihen re, fatmirësisht. Më lejoni t'ju jap dy shëmbuj:

Nga poetja gjermane Sarah Kirsch njohim një poezi të bukur për kafënë, d.m.th. për pijen e shijshme, gjallëruese. Është një poezi ku flitet ekskluzivisht për kafënë. Kështu që mund të quhet befasi kur njeriu duhet të konstatojë që në përkthimin shqip fjala gjermane "Bohne" – Kaffeebohne, kokrra, kokrra e kafesë – është përkthyer me "groshë". Ç'kërkojnë perimet në atë poezi? Besoj se gafa duhej të binte në sy edhe redaktorit ose redaktore kompetente, përpara se të hynte revista në shtyp.

Një problem me homografët, me fjalët me kuptime të ndryshme, por të njëjtin drejtshkrim, kishte një herë edhe përkthyesi gjenial Robert Shvarc, duke përkthyer poezi "Die Hoffenden" e Bert Brecht-it, shqip: Atyre që mbajnë shpresë. Ky, i joshur dhe i mashtruar në një farë menyre nga konteksti, ngatërroi fjalën "der Taube" (me a të hapur) – i shurdhri – me "die Taube" (me a të mbyllur) – pëllumbi –, mirëpo, për çudinë e madhe e lexuesit dygjuhës, gabimi nuk vihet re (në kllapa: shumë) në këtë përkthim të rrumbullakët, artistikisht të përkryer.

Pra, për të përkthyer një vepër letrare (dhe jo vetëm, për të përkthyer çdo gjë) njeriu duhet të zotëroj sa më mirë gjuhën nga përkthen. Por kjo me siguri nuk mjafton.

Sipas shumë gjasave, jo, me siguri absolute zotërimi i gjuhës priëse, gjuhës, në të cilën përkthehet, e quajmë shqip "gjuhën objektivi", gjermanisht "Zielsprache", anglisht "target language", frengjisht "langue cible", është akoma më e rëndësishme. Përkthyesi duhet të jetë një virtuoz i "gjuhës objektivi". A mund të realizohet "rikrijimi besnik" i veprës origjinale kur përkthyesi belbëzon (natyrisht në kuptimin figurativ)? Sipas bindjes sime, përkthyesi duhet të ketë të njëjtin pushtet mbi "gjuhën objektivi" sa autori mbi "gjuhën burimi", të njëjtin "Sprachmacht" (fuqi gjuhe) siç thuhet gjermanisht. Të paktën të njëjtën fuqi gjuhe, ndoshta më shumë. Nga një kolege ime gjermane është shprehja: "Përkthyesi është një shkrimtar pa fantazi." Deshi të thoshte që përkthyesi bën të njëjtën që si autor, vetëm që s'duhet të çajë kokën për përmbajtjen, ndërtimin, strukturën e tregimit. Ai mund të përqëndrohet në aspektin gjuhësor, gjë që mund të jetë në favor të përkthimit. Sigurisht përkthyesi i sotëm nuk ka të drejtë të përforcojë gjuhën e origjinalit siç ka qenë e vetkuptueshme për përkthyesit e antikitetit. Mirëpo, shumica e përkthyesve profesionist merren me autorë të ndryshëm, dhe idiomi vetjak i secilit autor duhet të jetë i ndieshëm edhe në përkthim. Përkthyesi duhet të jetë në gjendje "të flasë me gjuhë të tëhuajshuar", siç e quajti një shkenctar gjerman. S'ka gjë më të tmerrshme se sa përkthime të autorëve të ndryshëm që tingëllojnë të gjithë njësoj se përkthyesi njuh vetëm një gjuhë, një gjuhëz, idiomën e vet. Te një numër jo kaq të pakët të përkthimeve letrare vihet re se përkthyesi i imponon autorit gjuhën e vet me zor. Kjo nuk është e lejueshme. Fenomenin përkatës, sipas mendimit tim, e gjejmë sidomos në rastet ku përkthimi nuk është bërë në bazë të gjuhës origjinale, por të një gjuhe të tretë, vetë përkthim. Distanca më e madhe nga autori favorizon, me sa duket, largimin nga origjinali dhe imponimin e gjuhës së përkthyesit. Të përkthehet nga një gjuhë e tretë, mund të jetë "ultima ratio", po është çdo herë në dëm të veprës.

Dua të përmend diçka që nganjëherë harrohet: Edhe gjuha letrare ka burimet e saj në gjuhën e folur dhe mban në vete ligjet e kësaj të fundit. Flas për elementin trupor, për tingellimin e gjuhës. Filozofi i madh Friedrich Nietzsche, duke u ankuar për gjuhën e thatë (torturuese, sipas tij) të autorëve të tij bashkëkohor në Gjermani, krijoi termin "veshi i tretë", me të cilin njeriu kap ritmin, tingujt e gjuhës. Ndoshta "veshi i tretë" është diçka e ngjashme me "shqisen absolute e degjimit" në muzikë. "Veshi i tretë" mund të stërvitet, por një përkthyes që s'e ka, do të mbetet i kufizuar në mundësitë e tij.

Të paktën te ne në Gjermani mbrohet parimi që përkthyesi të përkthejë nga gjuha e huaj në gjuhën e tij amtare, të cilën e ka në gjak, të cilën jo vetëm e kupton, por e ndjen, e kap me të gjitha shqiset, deri në nuancat më të holla. Çdo rregulli, kjo dihet, ka përjashtime. Unë di që në Shqipëri kjo punë vlerësohet ndryshe. Një dogmë nuk ekziston, çdo gjë që sjell suksesin është e lejueshme.

Më lartë përmenda nevojën për të marrë vendime, për t'i matur alternativat. Në traditën e filologut rus Roman Ossipowitsch Jacobson flasim për "dominanten" e një teksti, të cilën duhet ta përcaktoj përkthyesi për të mos u devijuar. Këto mund të jenë elementet formale e tekstit ose edhe funksioni i tij. "Dominantja" e një teksti duhet të ruhet edhe në përkthim.

Dua të jap një shëmbull. Poeti i madh gjerman Friedrich Holderlin ka krijuar një seri odeshe të mrekullueshme, duke iu përmbajtur me përpikmëri metrikës së ndërlikuar dhe rregullave të rrepta të odeve klasike greke. Ne qoftë se në përkthimin shqip të odeve bie në sy menjëherë (pa marrë këtu me disa çështje të tjera) se aspektit formal, i cili në këtë rast pa dyshim është "dominantja", nuk është dhënë as rëndësia më e vogël, atëherë përkthimi duhet të quhet i dështuar, me gjithë mundimet e përkthyesit.

Të kalojmë në një kusht tjetër të nevojshëm në përkthimin letrar. Çdo vepër letrare krijohet në kontekstin e rrethanave të veçanta socio-kulturore të vendit përkatës dhe është mbarsur me elementet e kulturës së tij, në kuptimin e gjeruar të termit. Prandaj përkthyesi kryen edhe një mision ndërkulturor, jo vetëm ndërgjuhësor. Duhet të jetë i informuar për rrethanat historike, politike, kulturore, shoqërore, natyrore, gjuhësore etj. – të të dy rajoneve të tij të punës, nga vjen dhe ku mbërrin libri. Jo, nuk duhet të jetë vetëm i informuar, por duhet të njohë këto rrethana shumë mirë, mundësisht edhe nga përjetimi i vet. Ky aspekt luan një rol posaçërisht të madh p.sh. në përkthimet nga shqipja në gjermanishten, për shkak të pabarazive në zhvillim historik dhe pozitës e Shqipërisë midis botrave për një kohë shumë të gjatë. Mund të flisja shumë për këtë problem, mirëpo s'kemi kohë, dhe besoj se problemi njihet dhe pranohet kudo. Bile përbën sfondin e emërtimeve metaforike mjaft të përhapur për përkthyesin si "ndërtues ure midis kombeve" ose "vargatar që sjell veprën në anën tjetër të lumit të madh". Bile pash që z. Buçpapaj do të merret me këtë problem në një kumtesë tjetër. Desha të përmendja vetëm një një problem që të bëj me transformacionet e medha në ish-vendet lindore: Njohuria socio-kulturore duhet të aktualizohet vazhdimisht. Më lejoni t'ju tëheq vëmendjen në nevojën e përpunimit dhe ripërpunimit të fjalorëve ekzistues. Të paktën fjalorët që kam unë në përdorim (shqip-shqip, shqip-gjermanisht, gjermanisht-



shqip, anglisht-shqip, shqip-anglisht si dhe një seri fjalorësh special) vuan keq nga anakronizmi, d.m.th. përmbajtja e tyre nuk pasqyron fare zhvillimet e vrullshme ekonomike, shoqërore dhe politik të njëzet viteve të fundit. Ky problem çënon shumë përdorueshmërinë e fjalorëve.

Tema e fjalorëve më çon te një kusht tjetër të nevojshëm për përkthimin e arrirë: Përvetësimin e domosdosshëm të zanatit të përkthyesit. Të arti-zanatit, pra. Çdo art, dhe përkthimi është art, ka edhe anën e saj zanatçore. Kjo përfshin shumë gjë: Përkthyesi duhet të shtie në dorë të gjithë fjalorët që mund të gjej, dhe duhet të mësoj t'i përdorë. Gabimi më i madh është përdorimi mekanik në vend të hulumtimit për fjalën ose sinonimin më të përshtatshëm. Shumë përkthyes mbledhin dhe përpunojnë fjalorët e tyre vetjak. Gjithashtu, puna e përkthyesit nuk mund të mendohet pa hulumtime pak a shumë të hollësishme (Recherche, i thonë francezët dhe ndërkohë edhe gjermanet). Para njëzet vjetëve gjatë përkthimit të një libri nganjëherë kam kaluar ditë të tera në biblioteka të ndryshme, sot - me internetin – kjo punë është bërë shumë më e lehtë. Kush nuk përdor WIKIPEDIA për të mbushur boshlleqet në dijeninë e tij të grumbulluar, bën gabim. Nuk është gabim që të sigurohet njeriu a është vërtet ashtu siç mendon.

Sidomos përkthyesit të rinj nuk bëjnë mirë të nënvleftësojnë zanatin. Pa talent s'ka përkthim, por talenti mund të zhvillohet vetëm duke respektuar zanatin. Pretendoj se ka një talent të veçantë për përkthyes, por meqë nuk jam në gjendje ta përcaktoj, do të kenaqem me pretendimin.

Mos u çuditni që dua të përmend një tjetër kusht të nevojshëm për një karrierë si përkthyes: Flas për ndjenjen e përgjegjësisë, për korreksi dhe modesti. Nganjëherë më pyesin a mund të përkthimi më i mirë se libri origjinal. Është një pyetje e kot, prandaj nuk vlen të merremi me të. Përkthimi duhet të jetë i përshtatshëm, dhe një përkthim të mirë nuk mund të jetë në dëm të autorit. Por një gjë është e sigurt: Përkthimi i dobët, përkthimi i dështuar mund të shkatërrojë edhe veprën më të mirë letrare. Kjo do të thotë, mes të tjerave, që sidomos përkthyesit të rinj duhet të jenë maksimalisht të vetëdijshëm, duhet të vlerësojnë drejt aftësitë e tyre dhe duhet të heqin dorë nga planet ose porositë kur s'janë të sigurtë që do t'i përballojnë. Për shëmbull: Shkrimtari austriak Robert Musil i përket patjetër letërsisë botërore. Tregimi "Die Versuchung der stillen Veronika" (Ngasja e Veronikës së heshtur) është ndoshta vepra e tij më e veshtirë, më misterioze, me kërkesa jashtëzakonisht të larta për përkthyesin. Çdo përkthyes i ndërgjegjshëm do të mendohej gjatë përpara se të pranonte porosinë dhe t'i vishej punës. E kam gjetur tregimin në libraritë e Tiranës, të përkthyer në shqip, dhe duhet të them që përkthimi është i tmerrshëm, një parodi e vërtet. Mendjelehtësia, me të cilën është punuar, shfaqet kudo, duke filluar nga titulli. Sa i përket letërsisë gjermane të përkthyer në shqip, fatkeqësisht duhet të them se ky nuk është një shëmbull i rrallë. Shumica e autorëve me nam, kur janë përkthyer, nuk janë përkthyer mirë. Do të dëshiroja se Roberti i ndjerë të kishte pasur më shumë kohë dhe forcë. Do të dëshiroja që ai, në vend të autorit solid Remarque të kishte përkthyer Franc Kafkën, Robert Walser-in, Thomas Mann-in, Robert Musil-in ose Elias Canetti-n. E di që kushtet e atëhershme në Shqipëri nuk e kanë lejuar. Aq më shumë duhet të mundohem trashëgimtarët dhe trashëgimtarët e tij. Besoj

se ka shënje premtuese në fushën e përkthimit të letërsisë gjermane këtu, besoj se ekzistojnë mundësi për të ngritur nivelin, dhe ofroj ndihmën time. Qëndrimi indiferent ndaj vlerave letrare të botës dëmton edhe letërsinë shqiptare. Veprimtaria shëmbullore e Robert Shvarcit mund të vlejë si orientim.

Përveç ndjenjes së përgjegjësisë dua të përmend edhe lujalitetin. Përkthyesit profesionistë me profesion të lirë s'duhet të ndjejnë dashuri ose adhurim për secilin libër që e përkthejnë. Një pjesë e punës e tyre do të jetë jetë thjesht punë buke. Por çdo përkthyes serioz do të bëjë të mundshmen që çdo përkthim i tij të dalë sa më mirë. Lujaliteti me autorin përfshin edhe që përkthyesi të mos marrë pjesë në panairin e thashethemeve, me të cilin, më falni që e them, duket që është konfrontuar gati çdo shkrimtar dhe shkrimtar shqiptar. Përkthyesi si përkthyes duhet të jetë i paanshëm, ndryshe është i pandërgjegjëm dhe bën dëm.

Tani, në mos gaboj, kam arritur në fund të listës së kushteve të nevojshme që se bashku krijojnë atë kusht të mjaftueshëm për përkthimin e mirë letrar. Jo, diçka harrova: Një kusht paraprak për punën e suksesshme të përkthyesit është që ky të mbajë veten gjallë. Duhet të mbijetojë ...

Ka dy lloj përkthyesish: amatorët, kryesisht njerëz me arsim të lartë, bashkëpunëtorë të stafeve universitare me pagesë dhe një orar pune të rregullt, që shfrytëzojnë kohën e tyre të lirë për të përkthyer vepra që u duken të rëndësishme. Me punën e tyre të palodhshme që nganjëherë vazhdon vite me radhë, ata shpesh arrijnë të nxjerrin në dritë pjesë nga thesaret letrare të kombeve të tjera që pa këta "përkthyes hobie" nuk do të kishin zbarkuar në bregdetët tonë. Si shëmbull mund të vlen të "Kritikoni" i spanjollit Baltasar Gracian; 1014 faqet e këtij libri janë përkthyer dhe komentuar nga romanisti Hartmut Köhler dhe botuar në ish-Ammann Verlag në Zyrih.

Kategoria tjetër përbëhet nga përkthyesit profesionist që – të paktën te ne në Gjermani - me punën e tyre gjithashtu të palodhshëm përballojnë pjesën më të madhe të detyrave, për një shpërblim që mesatarisht arrin me veshirësi nivelin e asistencës sociale. Po të mos ishin bursat, çmimet përkthimi ose në radhë të parë bashkëshortët ose bashkëshortet, si në rastin tim, që na mbështesin çmendurinë tonë në menyrë më se bujare, numri i librave të përkthyer në tregun gjerman, austriak dhe zviceran do të ishte shumë më i vogël. Shkrimtari dhe filozofi francez Albert Camus mund të ketë pasur parasysh edhe aspektin financiar kur i quajti përkthyesit "luftëtarë sypatrembur që sulmojnë në kullën e Babelit".

Tani jemi njohur me luftëtarin sypatrembur, me urëndërtuesin dhe me traparin, por na mungon akoma përkthyesi "scout", gjurmëgjatësi në pyjet të dendur të letërsisë së huaj. Javen e kaluar lexova shkrimin e një kolegu që deklaroi se – sipas tij -sidomos përkthyesit e gjuhëve të vogla (në parantezë: ky term i shumëpërdorur s'ka të bëjë me numrin e banorëve të vendeve përkatëse) kanë për detyrë të zbulojnë autorë dhe libra të panjohur në pyllin e përmendur, dhe t'i ndihmojnë të kapërcëjnë kufijtë e gjuhës se tyre për të pushtuar botën. Në këtë drejtim jam mjaft skeptik. Pa asnjë dyshim, çdo përkthyes letrar serioz do të jetë një njohës i mirë i skenës letrare të gjuhës "së tij", dhe si i tillë sigurisht

do të ketë edhe nuhatjen për të zbuluar ndonjë margaritar. Por që provomimi i letërsisë së një gjuhe të lihet në duart e fukarenjve të mbingarkuar me punë që quajnë veten përkthyes të lirë, ky është një gabim i tmerrshëm. Me lejoni të përmend këtu disa shifra, pa i komentuar: Vetëm në tregun (siç kuptohet vetë) kapitalist të librit në Gjermani ka rreth 2.000 shtëpi botuese që për çdo vit botojnë 95.000 libra të rinj, nga të cilët rreth 4.500 janë përkthime, kështu që në këtë treg qarkullojnë afro 1 milion libra, në një kohë kur shtëpitë botuese dhe sidomos libraritë ankohen për krizën e thellë që i ka mbërthyer dhe edhe autorët të rinj respektivisht akoma të panjohur të gjuhës gjermane i pret një shtegtim i mundimshëm derisa gjejnë një botues. Jo, përfaqësimi i autorëve dhe promovimi i librave të tyre jashtë dhe brenda vendit është detyra autentike e agjentëve letrar. Për të mos harruar, sa u përket shkrimtarëve që duan të botohen jashtë, botuesit e vendeve burimi, të cilët duhet të marrin, duhej të merrnin aktivisht pjesë në rrjetin botëror të botuesve ndërkombëtar që komunikojnë pa ndërprerje me njëri-tjetrin dhe këmbëjnë, ç'do të thotë se marrin jo vetëm, por përpiqen edhe të japin. Me lejoni të them se në këtë drejtim, sipas përshtypjes sime, sistemi shqiptar i botimeve lë dukshëm për të dëshiruar. Por ky është stofi për një diskutim tjetër.

Çfarë thashë në fund, ndoshta nuk tingëlloi shumë optimist. Por në përgjithësi s'kemi shkak të dorëzohemi. Prandaj dua të përfundoj me një fjalë të urtë të heroit të pavdeks-hëm të letërsisë gjermane, Johan Wolfgang von Goethe:

"Me gjithë ato që mund të thuhet për mangësitë e përkthimit, ai është dhe do të mbetet një nga punët me të rëndësishme dhe më dinjitoze në zhvillimet e përgjithshme të botës."

Faleminderit për durimin tuaj.

© Joachim Röhm

Albanische Literatur in deutscher Übersetzung

[www.joachim-roehm.de](http://www.joachim-roehm.de)